



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 86

Prishtinë, më 24.07.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinkovic, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Ganimete Musliu, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Danush Ademi

Përfaqësuesit e Ministrisë së FSK-së: Agim Çeku, Ministër, Rrahman Rama, zv. Komandant i FSK-së dhe Shkelzen Syla, Sekretar i përhershëm në MFSK.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hoxha, Këshilltar nga OSCE, Sanije Berisha-OSCE, Dhurata Kryeziu- OSCE,

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

Raportimi i Ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës Z. Agim Çeku.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e rregullt të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe në emër të komisionit falënderoi Ministrin z.Çeku dhe bashkëpunëtorët e tij.

Tutje shtoi se ky takim është bazuar në raportet e vazhdueshme nga MFSK-ja, për të parë rrjedhën e zhvillimeve në FSK në mënyrë që të kemi një pasqyrë për tre mujorin e dytë për këtë vit, dhe të shihet mundësia e funksionimit më të mirë në të ardhmen.

Përgëzoi Ministrin, z. Agim Çeku, për vlerësimin e dhënë nga ana e NATO-së për FSK-në, për arritjen e kapaciteteve operationale nga ana e saj, forcë e cila është aspiratë e të gjithë qytetarëve që të jetë ushtri e ardhshme dhe që garanton paqe dhe siguri.

Ministri i FSK-së, Agim Çeku- Theksoi se FSK-ja është duke bërë progres të vazhdueshëm duke u ndërtuar në bazë të objektivave të përcaktuara për vitin 2013.

Objektivat për këtë vit janë:

1. Bërja e FSK-së forcë e vetëmjaftueshme dhe vazhdimi në ngritjen e kapaciteteve operationale.

Sa i përket këtij objektivi është arritur progresi mjaftueshëm, ku me 9 korrik 2013, NATO-ja ka marrë vendim me konsensus dhe ka deklaruar se FSK-ja përmbush kapacitetet e plota operationale.

Kjo është një certifikim që FSK-ja mundet ë mënyrë të pavarur të kryej detyrat që e obligojnë ligjet në fuqi.

Gjithashtu një nga elementet që është vlerësuar nga NATO-ja është mbikëqyrja demokratike ndaj FSK-së, funksionimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe bashkëpunimin me të, duke e konsideruar këtë sukses të përbashkët. Po ashtu mision i NATO-s ka qenë arritja e kapaciteteve të plota operacionale dhe për këtë qëllim ka investuar në FSK me dy ekipe këshilluese, Ekipi këshillues i NATO-s në Ministri dhe Divizioni Civilo-Ushtarak këshillues në forcë, të cilat gjithashtu e kanë pasur këtë mision.

Tani është paraparë ndërtimi i Qendrës Rajonale të kërkim Shpëtimit dhe pritet që në vitin e ardhshëm të certifikohet dhe të standardizohet sipas standardeve të Kombeve të Bashkuara dhe të jetë njësit i specializuar për pjesëmarrje në operatione të kërkim shpëtimit.

Vazhdohet me edukimin e oficerëve në trajnime dhe ushtrime fushore, aktualisht janë 3 oficer në shkollim jashtë vendit, SHBA, Turqi dhe Britani e Madhe.

Gjithashtu është bërë diplomimi i katedëve të rinj për vitin 2013 dhe është në përfundim e sipër seleksionimi për gjeneratën e re.

Ndërkohë zhvillohet kursi bazik i komuniteteve pakicë, ku janë 30 pjesëtarë, shumica nga komuniteti serb, dhe nga një përfaqësues të komunitetit turk, boshnjak dhe ashkali.

Po ashtu si FSK jemi të kyçur në operatione reale, ku çdo ditë pesë ekipe janë të kyçura në pesë lokacione për pastrimin e fushave të minuara.

Objektivi i dytë për vitin 2013 ka qenë dhe mbetet

2. Bërja e FSK-së forcë e besueshme dhe aktive.

Në këtë drejtim është arritur sukses, kjo është dukur ehe nga sondazhet që janë bërë në Kosovë duke e nxjerr FSK-në si institucionin më të besueshëm të sigurisë në Kosovë. FSK-ja është aktive duke u dalë në ndihmë autoriteteve civile, veçoj urën lëvizëse në fshatin Kreovik deh aktualisht jemi të angazhuar në një rrugë në Han të Elezit, gjithashtu mbështesim Ministrinë e Diasporës në organizimin e aktiviteteve të ndryshme, vazhdimisht vizitojmë zona rurale dhe tani është duke u zhvilluar aksioni i dhurimit vullnetar të gjakut.

3. Bërja e FSK-së forcë për të mirë në rajon.

Në këtë drejtim FSK-ja është aktive dhe trajtohet si partner i barabartë në rajon, janë mbajtur konferenca në nivel rajonal siç ishte Konferenca e Ministrave të Mbrojtjes e mbajtur në Shqipëri si dhe si dhe në Ohër të Kartës së Adriatikut .

Gjithashtu zhvillohen ushtrime rajonale, siç është ai i organizuar në Maqedoni nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë. Gjithashtu reagimi i përbashkët në Shqipëri e cila organizohet nga Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë si dhe kampi veror i katedëve në Maqedoni i cili organizohet nga Ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë.

Është nënshkruar marrëveshja për statusin e forcave në Republikën e Shqipërisë, pastaj vizita e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë të Malit të Zi, ndërsa nga vizita që kam realizuar në Slloveni kemi nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes së Sllovenisë.

4. Bërja e FSK-së forcë e zbarkueshme jashtë vendit .

Për këtë objektiv është hartuar korniza ligjore siç është Ligji për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, ndërsa bashkë me gardën kombëtare të Ajoves janë zhvilluar të gjitha procedurat që duhet ndjekur në përgatitjen e njësiteve dhe ushtarëve jashtë vendit.

5. Rishikimi i FSK-së dhe zhvillimi i FSK-së bazuar në rekomandimet e rishikimit.

Ky proces konsiderohet ndër më të rëndësishmit dhe se në kuadër të këtij procesi është një grup i përbërë nga oficer dhe zyrtar civil. Ky proces është duke u zhvilluar me ndihmën e ekipit të Pentagonit të SHBA-së,(DIRI)

Ndërsa në vitin e ardhshëm SHBA do të dërgoj këshilltar për Ministrinë e FSK-së ët cilët do të jenë të angazhuar për tre vite, ndërsa Ministria e Mbrojtjes e Gjermanisë ka ofruar një këshilltar i cili do të angazhohet nga viti i ardhshëm, kjo si rezultat i bashkëpunimit bilateral.

Në këtë fazë është duke u bërë analiza e kapaciteteve aktuale në çdo institucion të sigurisë dhe rezultat i analizës se çfarë kapaciteti duhet të ketë Kosova, po ashtu janë duke u identifikuar mangësitë e institucioneve të sigurisë në Kosovë.

Në këtë fazë jemi në diskutim e sipër për draftimin e raportit final dhe Strategjisë së Mbrojtjes Kombëtare dhe planin për ndryshimet ligjore si rezultat i këtij procesi.

6. Bërja e FSK-së partner i besueshëm i NATO-s dhe SHBA-së dhe vendeve të tjera.

Forca e Sigurisë së Kosovës trajtohet si partner me vendet e tjera, NATO-ja ka marrë vendim që ekipi këshillues i NATO-s të vazhdojë punë në Ministrinë e FSK-së dhe në vend të Divizionit Civilo-Ushtarak është formuar Ekip Ndërlidhës i Këshilltarëve të NATO-s, i cili ekip do të jetë në komandën e forcës tokësore.

Këto ekipe gjatë këtij mandati nuk kanë ndonjë synim të caktuar dhe mandati i tyre nuk lidhet me një zhvillim të caktuar të FSK-së dhe qëndrimi i tyre do të jetë më i gjatë sesa KFOR-i. Detyra e tyre është konsultim, këshillim dhe koordinim i asistencës me vendet e NATO-s, shkollimi oficerëve në shkollat e NATO-s.

Ndërsa me të gjitha vendet me të cilat kemi nënshkruar marrëveshje na trajtojnë si shtet, vlen të theksohet partneriteti me Gardën e Ajovas dhe është bërë lëvizje në programin e binjakëzimit me shtete të caktuara.

Rexhep Selimi- Theksoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së nuk e kufizon aktivitetin e vet vetëm në mbikëqyrje por që kjo mbikëqyrje të jetë pjesë e zhvillimeve të nevojshme të FSK-së.

Vlerësoi si korrekt raportimin e Ministrisë të FSK-së dhe inkurajoi që misioni i FSK-së të jetë në përputhje me vullnetin e qytetarëve të Kosovës, gjithashtu inkuadroi për punë të mëtutjeshme duke e marrë rolin e Komisionit si pjesë të zhvillimit të FSK-së.

Fatmir Xhelili- Konsideroi se vlerësimi i dhënë nga NATO-ja për FSK-në është cilësor dhe i rëndësishëm.

Tutje shtroi pyetje për Ministrinë e FSK-së dhe Sekretarin e Përgjithshëm të MFSK-së, si në vijim.

A është bërë planifikimi për rritjen e numrit të pjesëtarëve të FSK-së me rastin e zvogëlimit të pjesëtarëve të KFOR-it?

Ndërsa pyetja për z. Sylja.

Në kornizën afatmesme, a janë planifikuar shpenzimet tre vjeçare dhe a do ti plotësojnë ato shpenzime nevojat dhe kërkesat e zhvillimit të FSK-së për tri vitet e ardhshme?

Anton Quni- Përgëzoi për vlerësimin e NATO-s për FSK-në, ndërsa parashtrroi pyetje për Ministrinë e FSK-së, lidhur me kapacitetet e plota operationale.

Cili është mendimi jua z. Ministër për zhvillimin e flotës ajrore, pasi në disa raporte mungesa e saj është parë si pengesë për kryerjen e misioneve të caktuara, siç janë intervenimet e shpejta apo arritja në terrene të pa kalueshme?

Si do ta trajtoni këtë çështje në të ardhmen, cilat janë studimet dhe pritjet në këtë fushë?

Ganimete Musliu- Drejtoi pyetje për Ministrinë e FSK-së, z. Agim Çeku.

Sa është motivi dhe morali i pjesëtarëve të FSK-së për të shërbyer në të, pa dallime të komuniteteve?

Goran Marinković- Duke iu referuar raportimit të Ministrit, shihet që FSK-ja ka pasur rezultate ka marrë mirënjohje nga ushtria amerikane.

Pse nuk ka pasur përparime në rritjen e pjesëtarëve të komunitetit serb? Cili është problemi në rritjen e numrit të pjesëtarëve nga komuniteti serb dhe komuniteteve të tjera?

Danush Ademi- Pyetje për Ministrin Çeku, në konkursin e hapur nga FSK-ja për kadet të ri nga komuniteti ashkali kanë aplikuar rreth 80 persona dhe asnjëri nga këta nuk është pranuar.

Cila është arsye që nuk janë pranuar pjesëtar nga komuniteti ashkali?

Rasim Demiri- Drejtoi pyetje për Ministrin.

A ka pjesëtar të FSK-së me grada të larta nga komuniteti jo shumicë?

Si është bashkëpunimi me Bosnje dhe Hercegovinën, duke ditur që akoma nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës?

Agim Çeku- Në përgjigjeje të pyetjeve të bëra nga anëtarët e komisionit, tha se konstatimin e z. Selimi se rolin e komisionit përveç si mbikëqyrës e kemi konsideruar edhe si adresë për zgjidhjen e problemeve prandaj suksesin tonë e konsideroj të përbashkët me ju.

Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së z. Fatmir Xhelili lidhur me mundësinë e largimit të forcave të KFOR-it, tha se largimi i tyre është edhe synim i tyre por kjo varet nga stabiliteti i situatës së sigurisë, pasi synim i tyre është zvogëlimi në mënyrë graduale i këtij misioni. Mes FSK-së dhe KFOR-it janë zhvilluar konsultime për raportet që duhet të kenë këto dy forca.

Pikënisje e procesit të rishikimit strategjik kanë qenë supozimet planifikuese dhe gjatë këtij procesi janë marrë disa propozime. Ne si ministri nuk do të lejojmë zbrastira për sigurinë në vend dhe ky është qëndrim i NATO-s dhe institucioneve të sigurisë në Kosovë.

KFOR-i nuk ka datë të caktuar për vetë reduktim, por kjo do të bazohet në kushte dhe njëra ndër to është rregullimi i pikës kufitare me shtetin serb dhe dorëzimi i saj autoriteteve të Kosovës dhe ndërtimi i kapaciteteve të Kosovës për përmbushjen e detyrave.

Ndërsa sa i përket pyetjes së z. Quni në lidhje me flotën ajrore, kjo del si rezultat i analizës së kapaciteteve dhe do ta kemi këtë flotë. Në këtë drejtim janë bërë disa studime dhe kjo është pjesë e rishikimit dhe në fund do të vendoset se si do të shkoj zhvillimi i këtyre kapaciteteve dhe varet nga buxheti dhe është vendim i Qeverisë, nëse do të kemi një apo dy një flotë.

Në përgjigjeje të pyetjes së znj. Musliu, tha se motivi i pjesëtarëve të FSK-së është i lartë nga të gjitha komunitetet në Kosovë, përfshirë edhe komunitetin serb.

Në përgjigjeje të z. Danush Ademi tha se është synim që përbërja e FSK-së të reflektoj përbërjen e shoqërisë, gjithashtu numri i këtyre pjesëtarëve është i kufizuar sipas pakos së Ahtisarit në 2500 pjesëtar deh kriteret për pranimin kadetëve të rinj janë rigoroze dhe fokusi ka qenë rritja e pjesëtarëve nga komuniteti serb.

Në përgjigjeje të z. Demiri tha se marrëdhëniet Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë janë të llojit që edhe pse nuk e ka njohur akoma pavarësinë, në takimet e Ministrave të Mbrojtjes përfaqësuesi i tyre nuk e ka kundërshtuar prezencën e Kosovës.

Në përgjigjeje të z. Goran Marinković, tha se grada e Kapitenit është më e larta komunitetin pakicë, gjithashtu theksoi se në Akademinë ushtarake në Maqedoni shkollohen dy pjestar nga komuniteti serb, dy nga komuniteti boshnjak.

Shkelzen Syla, Sekretar i Përhershëm në MFSK- Në përgjigjeje të pyetjes së z. Xhelili, lidhur me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe planifikimin buxhetit, tha se ashtu siç e parasheh rregullorja janë bërë planifikimet e duhura për vitin 2013 dhe vitin 2014, 2015 dhe 2016. Buxheti i lejuar për Ministrinë e FSK-së dhe FSK-në për vitin 2014 është 42.4milion, për vitin 2015 është 44milion dhe për 2016 46.4milion.

Mesatarja e rritjes së buxhetit nga buxheti ekzistues i vitit fiskal 2013deri në përmbushje të kornizës afatmesme të shpenzimeve, ngritja e buxhetit për tre vitet(2014, 2015,2016) është 20% dhe mesatarja vjetore 7-8%.

Ky buxhet nuk do të përmbush me përpikëri kërkesat që dalin pas rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë.

Goran Marinković- Drejtoi pyetje për z. Shkelzen Syla

Theksoi se ka reaguar pasi nga MFSK-ja ka pranuar një ftesë në gjuhën angleze, ndërsa në Ditën e FSK-së nuk ka pasur përkthim në gjuhën serbe.

Pse nuk e respektoni Ligjin për Gjuhët Zyrtare?

Shkelzen Syla- Në përgjigjeje të pyetjes së z. Marinković tha se, Ministria e FSK-së gjithnjë tenton të zbatoj Ligjin për gjuhët zyrtare, mund të ndodh të ketë vonesa, por lëshimet nuk kanë qenë të qëllimshme dhe se këtë vërejtje do ta adreson tek zyra përkatëse.

Vjollca Krasniqi- Drejtoi pyetje për Ministrin Çeku si në vijim.

Në lidhje me Kazermën ushtarake *Zahir Pajaziti*, e cila tani është shndërruar në deponi të mbeturinave.

Nga kush menaxhohet kjo hapësirë, a është diskutuar nga ministrinë e tjera që ky objekt të mos lihet në mëshirë të kohës? A ndjeni përgjegjësi që për një kohë kjo hapësirë është përdorur nga ju, ndërsa tani është në këtë gjendje?

Ganimete Musliu- Marrë në konsideratë numrin e madh të interesuar për tu rekrutuar në FSK. Si e vlerëson këtë trend, si alternativë për punë apo dëshirë e madhe e tyre për të shërbyer në FSK?

Agim Çeku- Në përgjigjeje të pyetjes së znj. Vjollca Krasniqi tha se, shpreh keqardhje për gjendjen e Kazermës *Zahir Pajaziti*, pasi në kohën sa kam qenë Komandant i TMK-së është investuar në të. Ndërsa me rastin e shuarjes së TMK-së dhe krijimit të FSK-së numri i pjesëtarëve është zvogëluar dhe si rrjedhojë është dashur më pak hapësirë, ndërsa përgjegjësinë për menaxhimin saj e ka Ministria e Administratës Publike.

Në kuadër të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë, është formuar grupi punues për infrastrukturë i cili do të merret me identifikimin e institucioneve të sigurisë përfshirë edhe Kazermën *Zahir Pajaziti*, pasi vlera e këtij objekti është e nevojshme.

Ndërsa në përgjigjeje të znj.Musliu, tha se elementi social është i pranishëm por tek komuniteti shumicë ekziston dëshira e tyre për të shërbyer në forcë.

Rexhep Selimi- Pyetje për Gjeneral, Rrahman Rama.

A mendoni se institucionet e Kosovës, siç është Qeveria e Kosovës dhe Ministria e FSK-së, po e qojnë FSK-në drejt një ushtrie?

Kur e shihni veten si Gjeneral të Ushtrisë së Kosovës?

Rrahman Rama, Zv.Komandant i FSK-së- Pas përfundimit të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë dhe pas deklarimit të kapaciteteve do të jenë mundësitë e tjera për të ngritur FSK-në në nivel profesional dhe këto zhvillime janë në proces e sipër.

Kryetari i Komisionit- Falënderoi Ministrin e FSK-së z. Agim Çeku dhe bashkëpunëtorët e tij për raportimin duke shtuar se Komisioni do të mbështes FSK-në edhe më tutje në fushën e legjislacionit dhe mbikëqyrjes demokratike të tyre.

Pas përfundimit të raportimit të Ministrit, propozoi që të vazhdohet me harmonizimin e amendamenteve për projektligjet të cilat kanë ardhur me procedurë të përshpejtuar dhe fjalën ia kaloi z. Fatmir Xhelili, kryesues i grupit punues për këto projektligje.

Fatmir Xhelili- Theksoi se grupi punues ka shqyrtuar gjashtë projektligjet dhe se nga ky proces kanë dalë disa amendamente, të cilat janë më shumë të natyrës teknike por që e rrisin cilësinë e ligjeve dhe propozoi që këto amendamente të përkrahën nga anëtarët e Komisionit.

Gjithashtu propozoi që Raporti për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare për institucionet e sigurisë dhe rekomandimet të aprovohen në këtë takim.

Rexhep Selimi- Kërkoi që të cilësohet ky vazhdim i takimit si i rregullt apo ad-hoc, pasi mungesa e disa anëtarëve të Komisionit dhe mos njoftimi me kohë për këtë takim mund të përbëjë shkelje të proceduarve për thirrjen e mbledhjes së Komisionit.

Kryetari i Komisionit- Propozoi që ky takim të konsiderohet mbledhje e komisionit dhe anëtarët e tjerë që nuk janë prezent të njoftohen, duke e konsideruar mbledhje të jashtëzakonshme.

Fatmir Xhelili- Me qëllim të procedimit të shpejt të projektligjeve në Kuvend, amendamentet e propozuara mund të votohen dhe se të gjithë anëtarët e grupit punues e kanë në konsideratë këtë, prandaj propozoi që ky takim të jetë vazhdimësi e kësaj mbledhje, duke futur edhe dy pika të rendit të ditës, Amendamentet për projektligjet shqyrtuara dhe Raportin për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare për institucionet e sigurisë.

Kryetari i Komisionit- Propozoi për shtimin e pikave të rendit të ditës:

Votimi i amendamenteve për projektligjet e shqyrtuara dhe Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare për institucionet e sigurisë dhe rekomandimet.

U ra dakord që mbledhja të vazhdoj me këto pika shtesë të rendit të ditës:

1. Votimi i amendamenteve për projektligjet e shqyrtuara si në vijim:

Projektligjit nr. 04/L-219 për të Huajt.

Projektligjit nr. 04/L-217 për Azil.

Projektligjit nr. 04/L-216 për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit.

Projektligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Projektligjit nr. 04/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Projektligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.

2. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare për institucionet e sigurisë dhe rekomandimet.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e raportuesit , z. Fatmir Xhelili.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit nr.04/L-219 për të Huajt me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Amendamenti 1

Në paragrafin 4 të nenit 9 në gjuhën angleze fjala “MIA” zëvendësohet me fjalën “Government” ndërsa në gjuhën serbe fjala “MUP” duhet të zëvendësohet me fjalën “Vlada”

Amendamenti 2

Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 16 të fshihen.

Amendamenti 3

Në paragrafin 1 të nenit 17 fjala “jo më herët” të zëvendësohet me fjalën “jo më vonë”.

Amendamenti 4

Paragrafi 2 i nenit 26 fshihet.

Amendamenti 5

Në paragrafin 3 të nenit 29 në gjuhën serbe fjala “OTKAZANO” zëvendësohet me fjalën “ANNULLED” kurse fjala “ODUZETO” zëvendësohet me fjalën “REVOKED”

Amendamenti 6

Në paragrafin 2 të nenit 44, në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 95 dhe në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 98, pas fjalës “komision” shtohet fjala “i ankesave”.

Amendamenti 7

Paragrafi 4 i nenit 49 riformulohet si në vijim:

“Parashtrimi i kërkesës për qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar do të dorëzohet dhe shqyrtohet kur anëtarët e familjes janë duke qëndruar jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Përgjatimisht, në rrethana të caktuara, kërkesa për qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar mund të dorëzohet dhe shqyrtohet kur anëtarët e familjes gjenden në territorin e Republikës së Kosovës”

Amendamenti 8

Në paragrafin 1.1, paragrafi 1 i nenit 50 pas fjalës “bashkëshortët” shtohet fjala “ose partnerët”.

Amendamenti 9

Në paragrafin 1 të nenit 52 fjala “të nenit 51” të zëvendësohet me fjalën “të nenit 50” në tri gjuhët dhe në paragrafin 2 të këtij nenin vetëm në gjuhën angleze fjala “nenin 49” zëvendësohet me fjalën “neni 48”.

Amendamenti 10

Pas paragrafit 4 të nenit 52 shtohet një paragraf i ri si në vijim:

“Personave të cilët parashetrojnë kërkesë për qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar do t’u krijohen lehtësira për pajisje me vizë të nevojshme”

Amendamenti 11

Në paragrafi 1.1 të nenit 59 në gjuhën shqipe pas fjalës “trafikimit me njerëz” shtohet fjala “(në tekstin e mëtejshme viktimë)”

Amendamenti 12

Në paragrafin 4 të nenit 66 fjala “mungon nga Republika e Kosovës” zëvendësohet me fjalën “qëndron jashtë Republikës së Kosovës”

Amendamenti 13

Në paragrafin 2 të nenit 50 dhe në paragrafët 3.2 dhe 3.3 në paragrafin 3 të nenit 67 fjala “status i azilit” zëvendësohet me fjalën “status i refugjatit”.

Amendamenti 14

Në paragrafët 1 dhe 3 të nenit 67 fjala “mbi” zëvendësohet me fjalën “për”

Amendamenti 15

Në paragrafin 1.8 të nenit 81 “me marrëveshje kolektive” zëvendësohet me fjalën “ me aktet nënligjore të nxjerra nga Qeveria”

Amendamenti 16

Në paragrafin 1 të nenit 99 pas fjalës “Urdhri i dëbimit” shtohet fjala “jepet nga DSHAM”.

Amendamenti 17

Në paragrafin 1 të nenit 129 dhe paragrafin 1 të nenit 131 në gjuhën angleze shtohet fjala “ by police” dhe serbe “od straten policije” për tu harmonizuar me variantin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 18

Në paragrafin 1 të nenit 130 në gjuhën angleze dhe serbe shtohet fjala “Labour Inspectorate” dhe “Inspektorata za rada” për tu harmonizuar me variantin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 19

Në paragrafin 1.1 të nenit 137 në gjuhën angleze pas fjalës “according” shtohet fjaka “article 7”, për tu harmonizuar me variantin shqip dhe serbisht.

Amendamenti 20

Në paragrafin 1.6 të nenit 137, fjala “neni 95” zëvendësohet me fjalën “neni 94” në tri gjuhët.

Amendamenti 21

Në paragrafin 1.28 të nenit 3, në paragrafin 1 të nenit 43, në paragrafin 3 të nenit 52, në nën paragrafin 2.2 të paragrafit 2 të nenit 96, në nën paragrafët 1.3 dhe 1.6, të paragrafit 1 të nenit 100, dhe në titullin dhe tekstin e nenit 112 fjalët “i mitur i pashoqëruar” zëvendësohen me fjalët “fëmijë i pashoqëruar” vetëm në gjuhën shqipe.

Amendamenti 22

Në nenin 61 fjalët “nuk duhet të jetë më e shkurtër se 3 muaj” zëvendësohet me fjalët “duhet të jetë prej 30 deri 90 ditë”

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e raportuesit , z. Fatmir Xhelili.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit nr. nr. 04/L-217 për Azil me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Amendamenti 1

Në pikën 2 të nën paragrafit 1.19, në nën paragrafët 1.21 dhe 1.23 të nenit 2, në paragrafin 1 dhe në nën paragrafin 7.3 dhe 7.4 të nenit 14, në nën paragrafin 1.6 të nenit 19, në paragrafin 3 të nenit 54 dhe në paragrafin 1 të nenit 95 fjala “i mitur” zëvendësohet me fjalën “fëmijë”

Amendamenti 2

Pas nenit 98 shtohet nen i ri si në vijim:

Neni 99

Përcaktimi i vendeve të Sigurta

Qeveria e Kosovës me vendim përcakton listën e vendeve të sigurta e cila mund ti nënshtrohet një shqyrtimi periodik.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e raportuesit , z. Fatmir Xhelili.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit nr. nr. 04/L-216 për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Amendamenti 1

Fjala “Ndërkufij” zëvendësohet me fjalën “ndërkufitar” në tërë tekstin e Projektligjit.

Amendamenti 2

Kreu III dhe neni 7 fjala “Agjencia” zëvendësohet me fjalën “Autoriteteve”

Amendamenti 3

Neni 12 Titulli dhe tërë teksti i neni fjala “ Marrëveshjet” zëvendësohet me fjalën “Marrëveshjet ndërmjet Autoriteteve”

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e raportuesit , z. Fatmir Xhelili.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Amendamenti 1

Neni 8, të ndryshohet titulli i neni nga “Emërimi i Koordinatorit” të zëvendësohet me “Emërimi dhe Kompetencat e Koordinatorit”

Amendamenti 2

Neni 11, paragrafi 4 fjala “mund” të bëhet “duhet”

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e raportuesit , z. Fatmir Xhelili.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit nr. 04/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Amendamenti 1

Në nenin 10 me të cilin riformulohet neni i ri 26A me titull "Trafiku lokal kufitar" i ligjit bazik fjalët "banorët kufitar" zëvendësohen me fjalët "banorët e zonës kufitare"

Rexhep Selimi- U shpreh kundër amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, duke theksuar se në nenin 32 të këtij projektligji citoj: *1. Të gjithë personat të cilët më 1 janar 1998 kanë qenë shtetas të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe që me këtë datë e kanë pasur banimin e përhershëm në Republikën e Kosovës konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës dhe regjistrohen si të tillë në regjistrin e shtetasve pa marrë parasysh vendbanimin ose shtetësinë që posedojnë aktualisht.*

Për këtë nen kam shpreh pakënaqësinë dhe kam konsideruar diskriminues, duke e marrë datën 1 janar si pikënisje, prandaj me ose pa përkrahjen Komisionit do të propozoj një amendament për këtë projektligj.

Fatmir Xhelili- Theksoi se një prerje e tillë kohore siç është 1 janari në këtë projektligj, është praktikë ndërkombëtare, ndërsa janë tre nene të tjera të këtij projektligji që u mundësojnë të gjithë qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë lindur në Kosovë dhe që nuk kanë qenë deri më 1 janar në Kosovë, u mundëson marrjen e shtetësisë, mjafton parashtrimi i kërkesës.

Për këtë arsye jam kundër që amendamenti i z. Selimi të pranohet si amendament i Komisionit.

Rexhep Selimi- Çështja është tek lehtësimi që krijon ky projektligj për qytetarët për marrjen e shtetësisë, ndërkohë që një lehtësim i tillë nuk është për qytetarët e Kosovës në një vend tjetër.

Amendamenti im pasqyron edhe qëndrimin e subjektit politik që e përfaqëso, pasi ky nen i jep përparësi qytetarëve të tjerë dhe në cilësinë e deputetit mund të bëjë amendament të veçantë pa përkrahjen e Komisionit, dhe se deklarimi im verbal duhet të merret parasysh pasi nuk e kam të gatshëm tani, dhe këtë amendament do ta paraqes me shkrim.

Pas diskutimit Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me pesë vota për (Ahmet Isufi, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Danush Ademi dhe një kundër (Rexhep Selimi) nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e raportuesit, z. Fatmir Xhelili.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Amendamenti 1

Mbi titullin e nenit 6, fjalia "1. Fitimi i shtetësisë me lindje" fshihet.

Amendamenti 2

Mbi titullin e nenit 8, fjalia: “2. Fitimi i shtetësisë me adoptim” fshihet.

Amendamenti 3

Mbi titullin e nenit 9, fjalia: “3. Fitimi i shtetësisë me natyralizim” fshihet.

Amendamenti 4

Nën paragrafi 2.1 i paragrafit 2. të nenit 24, riformulohet si vijon.

Kur shtetasi qëllimisht i është bashkuar një organizate e cila ka për qëllim rrënimin ose dëmtimin e rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës, ose”

2. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare për institucionet e sigurisë dhe rekomandimet.

Fatmir Xhelili- Si kryesues i grupit punues për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare për institucionet e sigurisë, falënderoi znj. Vjollca Krasniqi dhe z. Rexhep Selimi për kontributin e tyre gjatë kësaj mbikëqyrje, gjithashtu falënderoi përfaqësuesit e KRPP-së dhe OSBE-në e cila ka ofruar mbështetje me një ekspert.

Propozoj që rekomandimet e dala të përkrahën nga anëtarët e Komisionit, gjithashtu gjatë kësaj mbikëqyrje janë gjetur shkelje esenciale procedurale duke shkelur rregullat dhe ligjet në fuqi.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti për mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare të institucioneve të sigurisë dhe rekomandimet e raportuesit, z. Fatmir Xhelili.

Kryetari i Komisionit- Në mbyllje të këtij takimi falënderoi anëtarët e Komisionit për angazhimin e tyre gjatë kësaj periudhe dhe e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi